



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

RELACION PËR

MIRATIMIN E VEND DEPOZITIMIT TE MBETJEVE INERTE

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetë Qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 64, pika a); ligjin Nr.10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e mbetjeve të integruara", të ndryshuar, Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, për të disiplinuar mbetjet inerte të dala nga ndërtimet e kryera në territorin e Bashkisë Korçë

Kërkon:

1. Miratimin vend depozitimit të mbetjeve inerte në Ish Gurorja në anën perëndimore të rrugës Lumalas - Melçan,



Aktivitetet ndërtimore në përgjithësi janë burim i prodhimit të sasive të mëdha të mbetjeve. Mbetjet gjenerohen jo vetëm përkohësisht gjatë fazës së ndërtimit, por edhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës operative si dhe për efekt të proceseve të mirëmbajtjes së strukturave.

Impakti nga gjenerimi i mbetjeve është i përhershëm dhe në mjaft raste i pakthyesëm në lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore. Prandaj ky impakt ndaj mjedisit duhet të pakësohet me anë të masave për menaxhimin e mbetjeve.

Vendi i përcaktuar nga Bashkia është një sipërfaqe e shfrytëzuar për prodhim gurësh (gurore), sot e abandonuar, në pronësi shtet, në pronën me Nr. Pasurie 286/22, ZK. 2641, lloji i pasurisë shkëmbore, me sipërfaqe 135 754 m², në anën perëndimore të rrugës Lumalas – Melçan. Fillimi i procedurave për këtë vend depozitimi është miratuar ne Vendim të Këshillit të Bashkisë Nr. 24, datë 27.02.2020 .

Në datën 14.02.2022, me nr.aplikimi AN210120220001, është miratuar VNM Paraprake. Pasi kanë përfunduar procedurat ligjore të miratimit nga AKM, kërkojmë miratimin përfundimtar të këtij vend depozitimi.

Drejtor i D.P.K.ZH.T.


Urb. Zhaneta LUBONJA

Drejtoreshë e Dr. së Përgjithshme
Juridike dhe e Menaxhimit të
Burimeve Njerëzore


Anxhela (DISHNICA) QERAMIXHI

SOTIRAQ FILO


KRYETAR I BASHKISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P / V E N D I M

Nr. _____ datë _____

PËR

MIRATIMIN E VEND DEPOZITIMIT TE MBETJEVE INERTE

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë "Për miratimin e vend depozitimit të mbetjeve inerte", mbështetur në: Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetë Qeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 64, pika a); ligjin Nr.10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e mbetjeve të integruara", të ndryshuar, Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", për të disiplinuar mbetjet inerte të dala nga ndërtimet e kryera në territorin e Bashkisë Korçë, në kompetencat që ka dhe pas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

- I. Të miratojë vend depozitimit të mbetjeve inerte në Ish Gurorja në anën perëndimore të rrugës Lumalas – Melçan, në pronën me Nr. Pasurie 286/22, ZK. 2641, lloji i pasurisë shkëmbore, me sipërfaqe 135 754 m², (bashkëngjitur Plan Vendosja).
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës e të tjera, Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE

Ana VERUSHI

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM
Nr. 24 Datë 27.02.2020

PËR

**MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS PËR VEND DEPOZITIMIN
E MBETJEVE INERTE**

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë "Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë", mbështetur në: Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetë Qeverisjes vendore", neni 8, pika 2, neni 64, pika a); ligjin Nr.10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e mbetjeve të integruara", të ndryshuar, Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.07, datë 08.02.2017, "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Korçë", për të disiplinuar mbetjet inerte të dala nga ndërtimet e kryera në territorin e Bashkisë Korçë, në kompetencat që ka dhe pas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :


- I. Të miratojë fillimin e procedurës për vend depozitim të mbetjeve inerte në pronën me Nr. Pasurie 286/22, ZK. 2641, lloji i pasurisë shkëmbore, me sipërfaqe 149 412.3 m², në anën perëndimore të rrugës Lumalas – Melçan, (bashkëngjitur Plan Vendosi).
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës dhe Drejtoria e Prokurimeve.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.


ERJON NEXHIPI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


PLANVENDOSJE

Vendepozitimi i mbetjeve inerte, Fshati Melcan, Nj. Adm. Q. Bulgarrec, Bashkia Korçe

SH. 1:2500



2641
MELCAN

286/22

Pas. nr. 286/22

— Kufi prone
Siperfaqe Parcele = 149412.30 m²

PUNOI:

Ing. Esmerald Muçollari

DREJTORE D. P. K. ZH. T. :

Zhaneta Lubonja